



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE
PROJEKT-VENDIM

Nr. 01 Date 11 / 11 / 2021

**“Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër,
Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2022”**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, pika “dh”, në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligji nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

KËRKOJMË:

1. Miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Dibër si më poshte:
 - 1.1 Në administratë numri i punonjësve të jetë 466 punonjës.
 - 1.2 Në institucionet në vartësi të Bashkisë Dibër numri i punonjësve të jetë 74 punonjës.
 - 1.3 Funkcionet e deleguara (Arsimi 209 punonjës, Shërbimi Pyjor 10 punonjës, Ujitja dhe Kullimi 4 punonjës, MNZSH 21 punonjës, Gjendja Civile në Njësit Administrative dhe Bashki 14 punonjës, QKB 2 punonjës) gjithsej 260 punonjës.
 - 1.4 Punonjës me kontratë pune të përkohshme mujore (4-8 muaj) për punë sezonale sipas nevojave të institucionit të jenë 10 punonjës .

2.Shuma Totale e punonjesve te jete 810 (tetëqind e dhjetë) sipas tabelës së mëposhtme:

Punonjes te Administrates	466
Institucione ne Varesi	74
Funksione te Deleguara	260
Punonjes Sezonal me Kontrata 4-8 Muaj	10
Shuma Totale M.B.NJ	810

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore

Malbora Lala



Përgjegjëse e Sektorit Juridik

Elona Lusha



Drejtori Ekonomik

Lorenc Cibaku



KRYETARI I BASHKISË NË DETYRË

Shkelqim MURRJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

RELACION

“Me të dhëna të grupuara, për numrin e punonjësve për projekt strukturën e Bashkisë Dibër, që mendohet të hartohet e miratohet për vitin kalendarik 2022”

{Praktikë shkresore me të cilën shoqërohet Projekt vendimi “Për miratimin e numrit të punonjësve gjithsej të Bashkisë Dibër për vitin 2022 me miratimin e të cilit do të hartohet e miratohet struktura e bashkisë për vitin 2022}

KËSHILLIT TË BASHKISË DIBËR

Në zbatim të dispozitave të ligjit 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” pika “dh”, citohet “ *miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;*

Referuar në raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit në Bashkinë Dibër. Në masat organizative nga auditimi rezulton se ka një rritje të numrit të punonjësve dhe pse numri i përgjithshëm duhet të ishte në ulje për shkak të reformës territoriale. Klsh ka rekomanduar që nga Bashkia Dibër të merren masat e nevojshme për krijimin e një strukturë organizative eficiente në referim të numrit të përgjithshëm të banorëve , me qëllim ushtrimin me efektivitet dhe ekonomikitet të funksioneve bazë të njësisë. Gjithashtu edhe në raportet e Ministrisë së Financave është lënë rekomandim për shkurtimin e numrit të punonjësve në hartimin e PBA(Projekt Buxheti Afatmesem)2019-2022.

Në vijimësi të praktikave të punës të ndjekura e përdorura në plotësimin e detyrave që ngarkon legjislacioni respektiv në vitet paraardhëse (2019,2020 dhe vitit 2021 që po mbylлим),është menduar që numri i punonjësve gjithsej të Bashkisë Dibër për vitin 2022 të jetë me i ulët se numri i punonjësve gjithsej të Bashkisë Dibër për vitin 2021 me një ndryshim prej 23 punonjësish .

Numri i punonjësve gjithsejt sipas strukturave që jepen në pasqyrën përmbledhëse në këtë relacion, është paraprirë në këtë nivel duke i`u referuar përcaktimeve që jepen në ligjin 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe konkretisht në :

Kreu VII Funksionet dhe kopetencat e e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore ,

Neni 21- Llojet e funksioneve,

Neni 22- Parimet për ushtrimin e funksioneve,

Neni 23-Funksionete Bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike,

Adresa: Bulevardi “ELEZ ISUFI”, Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com nr.tel:0035521822935

Neni 24- Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale,

Neni 25- Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese,

Neni 26 - Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes mjedisit,

Neni 27 - Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë,zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, dhe natyrës së biodiversitetit ,

Neni 28 - Funksionet e bashkive në fushën e Zhvillimit ekonomik vendor,

Neni 29- Funksionet e bashkive në fushën e Sigurisë Publike

Neni 30- Funksionet dhe kopetencat e deleguara

Ky relacion që i bashkëlidhet Projekt vendimit “Për miratimin e numrit gjithsejt të punonjesve të bashkisë për vitin 2022 ”është përpiluar referuar përcaktimeve që bëhen në nenet që vijnë në ligjit 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,konkretisht:

Neni 54 - Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak,pika “dh”

Neni 64 – Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë ,pika “j”

Në pasqyrën që vijon jepet numri i menduar për miratim i punonjësve për vitin 2022 sipas strukturave të vecanta të bashkisë ,praktikë e cila do të jetë bazë për hartimin dhe miratimin e strukturës së bashkisë për vitin 2022 ne forme sintetike dhe analitike .

Nr.	Emërtimi i strukturave	Nëpunës /punonjës viti 2021	Projekt, Nëpunës /punonjës viti 2022
	Administrata e Bashkise		
1.	Kryetari i bashkisë	1	1
2.	Nënkryetarë të bashkisë	1	1
3.	Sekretari i Përgjithshëm	1	1
4.	Sekretari i këshillit bashkiak	1	1
5.	Spektori Integritit Europian	4	4
6.	Kabineti i Kryetarit	3	3
7.	Spektori i Auditit	3	3
8.	Spektori i IMTV	5	5
9.	Spektori i Prokurimeve	4	4
10.	Spektori i Pronave	4	4
11.	Drejtoria e Kopshteve dhe Çerdheve	65	65
12.	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	35	35
13.	Drejtoria ekonomike	48	46
14.	Spektori i policisë bashkiake	12	12

15.	Drejtoria e Bujqësisë	15	13
16.	Drejtoria e PPECK	5	5
17.	Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit	8	8
18.	Drejtoria e Shërbimeve Publike	147	155
19.	Njësitë Administrative (me punonjes shërbimesh	100	100
	S h u m a :	462	466
	Institucione ne varësi		
20.	Pallati i Kulturës	24	25
21.	Klubi Shumësportëshdhe Futbolli "Korabi"	14	14
22.	Qendra Balneare "Enver Shehu" Peshkopi	20	35
	S h u m a :	58	74
	Funksione te deleguara		
23.	Drejtoria e MZSH-s	21	21
24.	Zyrat e gjendjes civile (dhe Njësi Administrative)	14	14
25.	Zyra e QKB-s	2	2
26.	Spektori i Pyjeve dhe Kullotave	10	10
27.	Spektori i Administrimit të Ujërave	4	4
28.	Arsimi Parashkollor	209	209
29.	Projekti "Tungjatjeta Jetë"	5	0
30.	Njësi Levizese Fush-Çidhen/Slllove	4	0
	S h u m a :	269	260
31.	Punonjes sezonal	44	10
	Administrata ne Total	462	466
	Institucione ne Varesi	58	74
	Punonjes te deleguar	269	260
	Punonjes sezonal	44	10
	GJITHSEJ	833	810

Konkretisht në interpretim të tabelës ndryshimet e bëra do të jenë :

- Kabineti i Kryetarit nuk do të ketë ndryshime .
- Sektorët të cilët nuk do të kenë ndryshime janë :

- a) Sektori i Integrimit European
 - b) Sektori i Prokurimeve
 - c) Sektori i Pronave
 - d) Sektori i Auditit
 - e) Sektori i IMTV
 - f) Sektori i Policisë Bashkiake
- Drejtoria e Kopshteve dhe Çerdheve e cila do të ketë në varësi 3 Sektore nuk do të ketë ndryshime në numër :
 - a) Sektori i Çerdheve
 - b) Sektori i Konviktit
 - c) Sektori i Arsimit
 - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e cila do të ketë në varësi 3 Sektore nuk do të ketë ndryshime në numër :
 - a) Sektori Juridik
 - b) Sektori i Burimeve Njerëzore
 - c) Sektori i Teknologjisë, Informacionit dhe Arkivi
 - Drejtoria Ekonomike e cila do të ketë në varësi 3 sektore nga 48 që është numri aktual i punonjësve për vitin 2022 numri i punonjësve do të ulet në 46 bazuar në kërkesën e Drejtorisë Ekonomike për të shkurtuar 2 pozicione pune pranë Sektorit të Taksave .
 - a) Sektori i Financës
 - b) Sektori i Taksave
 - c) Sektori i Kujdesit Social
 - Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit e cila do të ketë në varësi 2 Sektore nuk do të ketë ndryshime në numër :
 - a) Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Studim Projektimit
 - b) Sektori i Mbrojt. Mjedisit dhe Administ. të Rregjistrimit
 - Drejtoria e Bujqësisë e cila do të ketë në varësi 5 Sektore nga 15 që është numri aktual i punonjësve për vitin 2022 numri i punonjësve do të ulet në 13 bazuar në kërkesën e Drejtorisë për të shkurtuar 2 pozicione pune.
 - a) Sektori i Bujqësisë
 - b) Sektori i Pyjeve dhe Kullotave (Fond i Deleguar)
 - c) Sektori i Administrimit të Ujërave (Fond i Deleguar)
 - d) Sektori i Mjedisit dhe Tokave
 - e) Sektori i Veterinarisë
 - Drejtoria e PPECK do të jetë e pandryshuar në numër.
 - Drejtoria e Shërbimeve Publike e cila do të ketë 3 sektore në varësi nga 147 punonjës që është numri aktual, për vitin 2022 numri i punonjësve do të rritet në 155 kjo rritje numri

vjen bazuar në kërkesat e Drejtorëve të shkollave për shtim personeli të sanitareve është menduar e arsyeshme që të shtohen disa pozicione pune sanitare në shkollat me numër më të lartë të nxënësve për mirëmbajtjen e higjienës nëpër shkolla .

- a) Sektori i Menaxhimit të Mbejtjeve dhe Gjellbërimit
- b) Sektori i Transportit dhe Ndricimit Publik
- c) Sektori i Mirëmbajtjes së Objekteve dhe Rrugëve

- Njësitë Administrative nuk do të kenë ndryshime në numër.
- Institucionet në varësi do të jenë me një numër më të lartë punonjësish si vijon:
Qendra Balneare “Enver Shehu” aktualisht ka 20 punonjës definitiv dhe 15 punonjës kanë qenë me kontratë të përkohshme .

Bazuar në kërkesën e Drejtorisë së Qendrës Balneare dhe duke parë ngërcin e krijuar nga mbarimi i kontratës në fillim të muajit Tetor në kulmin e sezonit është menduar që për vitin 2022 numri total të jetë 35 punonjës me kohë të plotë .

- a) Qendra Balneare “Enver Shehu”
- b) Qendra Kulturore Peshkopi
- c) Klubi i Futbollit “Korabi”
- d) Klubi Shumësportësh “Korabi”

- Funkcionet e deleguara do të jenë më të pakta në numër kjo vjen si pasojë e mbarimit të kontratës të Njësisë Lëvizëse Fushë-Çidhën/ Sllovë dhe Projekti “Tungjatjeta Jetë” perfundon kontratën në fillim të vitit 2022.

- a) Drejtoria e MZSH-së
- b) Sektori i Pyjeve dhe Kullotave
- c) Sektori i Administrimit të Ujerave
- d) Gjendja Civile
- e) Zyrat e QKB-së
- f) Arsimi Parashkollor

- Punonjës Sezonal do të jenë më të pakta në numër. Nga 44 punonjës për vitin 2021 është menduar që për vitin 2022 numri i punonjësve sezonal të jetë 10 për shkak se punonjësit sezonal pranë Qendrës Balneare është propozuar që për vitin 2022 të jenë punonjës me kohë të plotë.

Duke shpresuar në mirëkuptimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak për miratimin e Projekt vendimit “Për miratimin e numrit gjithsej të punonjësve të Administratës së Bashkisë Diber Institucioneve në vartësi dhe të Njësisve Administrarive për vitin 2022”.

Ju faleminderit!

Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore

Malbora LALA



Adresa: Bulevardi “ELEZ ISUFI”, Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com nr.tel:0035521822935



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 64 Datë 24.12.2021

**“ Miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër,
Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2022”**

Mbështetur ne ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, pika “dh”, në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligji nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **24.12.2021** miratoi me **17** vota pro **1** kunder **1** apstenim.

VENDOSI :

1. Miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Dibër me ndryshime nga projekti I sjelle nga Bashkia me nr 466 te punonjesve duke shtuar 20 punonjes :
 - 1.1 Në administratë numri i punonjësve të jetë 486 punonjës.
 - 1.2 Në institucionet në vartësi të Bashkisë Dibër numri i punonjësve të jetë 74 punonjës.
 - 1.3 Funksionet e deleguara (Arsimi 209 punonjës, Shërbimi Pyjor 10 punonjës, Ujitja dhe Kullimi 4 punonjës, MNZSH 21 punonjës, Gjendja Civile në Njësit Administrative dhe Bashki 14 punonjës, QKB 2 punonjës) gjithsej 260 punonjës.
 - 1.4 Punonjes me kontratë pune të përkohshme mujore (4-8 muaj) për punë sezonale sipas nevojave të institucionit të jenë 10 punonjës .


2.Shuma Totale e punonjesve te jete 830 (tetëqind e tridhjetë) sipas tabelës së mëposhtme:

Punonjes te Administrates	486
Institucione ne Varesi	74
Funksione te Deleguara	260
Punonjes Sezonal me Kontrata 4-8 Muaj	10
Shuma Totale M.B.NJ	830

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Sherbimeve Mbeshtetese dhe Drejtoria Ekonomike Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall sot me date **24.12.2021**

Kryetar Këshilli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1240/1 prot.

Peshkopi, më 31.12.2021

Lenda : Mbi verifikimin e ligjshmerise te vendimit nr.64 date 24.12.2021

Drejtuar: **BASHKISË DIBER**

DIBER

Në mbështetje të ligjit *nr.107, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut"*, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e këshillit të bashkisë Diber, *Nr 64, datë 24. 12.2021 "miratimin e numrit te punonjesve të administratës së Bashkisë Diber, Institucioneve ne varësi dhe te njësive Administrative per vitin 2022"*, vendosa miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike të spec ifikuara në pjesën hyrëse të aktit administrative objekt verifikimi dhe shqyrtimi.

P R E F E K T I
- Nexhbedin SHEHU -

